

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja

Viti i 80-të i botimit
Nr. 3



**Flamuri shqiptar,
dy vjet në qiellin
europian**

MINISTRI I MBROJTJES ARBEN IMAMI MERR PJESË NË RIVARRIMIN
E ATDHETARIT TË KOMBIT SHQIPTAR, SHAHIN TOÇI


Të prehesh në vendlindje një vlerësim i madh



Eshtrat e Dëshmorit të Atdheut, Shahin Toçi, më në fund do të prehen të qeta në vendlindjen e tij, Burrel. Në një ceremoni solemne të organizuar nga Bashkia e Burrelit, familja e të ndjerit Toçi dhe me përkrahjen e Ministrisë së Mbrojtjes, eshtrat e Dëshmorit të Atdheut, kanë mbërritur nga Italia në Shqipëri, më datën 25 mars për t'u rivarrosur këtë të shtunë në vendin

që Shahin Toçi aq shumë e donte, në Atdhe. Homazhet për nder të Dëshmorit Toçi, i cili nuk u përkul as përballë plumbave të fashistëve italianë duke pranuar edhe vdekjen, nisën në hollin e Bashkisë Burrel, ku mes familjarëve, të afermeve dhe miqve të familjes Toçi, ishte i pranishëm edhe Ministri i Mbrojtjes Shqiptare, Z. Arben Imami, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Major Maksim Malaj, përfaqësues të Presidencës, deputetë të Parlamentit Shqiptar, Princi Leka Zogu, drejtues forcash në FA, etj. Pas kryerjes së homazheve në hollin e Bashkisë, ceremonia u zhvendos në Varrezat e Dëshmoreve të rrethit Mat, ku u bë edhe rivarrimi i eshtrave të të ndjerit Toçi. Përveç kurorave me lule të vendosura nga krerët më të lartë që merrnin pjesë në këtë ceremoni, skuadra e pushkatarëve përshëndeti me të shtëna armësh në nder të dëshmorit. Ceremonia solemne vijoi më pas në Qendrën Kulturorë Burrel, ku një fjalim përshëndetës u mbajt edhe nga Ministri i Mbrojtjes Arben Imami. Duke iu drejtuar familjarëve të familjes Toçi dhe të gjithë qytetarëve që kishin mbushur sallën, Ministri Imami u shpreh: "Është një ditë e veçantë për të gjithë ne që vijmë sot për të nderuar veprën e një patrioti të madh shqiptar. Kjo është një ditë emocionesh të veçanta, sepse ky nuk është një akt i thjeshtë kujtese, ky është një akt aktualizimi i dhembjes sonë, respektit tonë, nderimit tonë, për Shahin Toçin, Dëshmor të Atdheut. Ky është një akt nderimi për të gjithë ata burra trima, patriotë, luftetare, dëshmorë, heronj që sakrifkuan jetën dhe gjithçka për lirinë e këtij vendi, që sakrifkuan gjithçka për flamurin tonë kombëtar, se ky flamur dhe ky vend është i larë me gjakun e tyre. Ky akt i madh civil sot bëri të mundur që eshtrat e Shahin Toçit të prehen në vendin e tij të lindjes, në Atdheun e tij, që sot është ashtu siç ai e kishte dashur, një vend i lirë mes vendesh të lira. Që sot, eshtrat e Shahin Toçit, e këtij patrioti që u shpall Dëshmor të Atdheut në vitin 1970, do të pushojnë në Matin e tij të dashur, në këtë tokë trimash e burrash fisnikë dhe do të bëhet përherë e më i paharrueshëm patriotizmi dhe kontributi i tij për lirinë e vendit", nënvizoi Ministri Imami. Duke u kthyer pas në kohë e duke bërë një retrospektive mbi jetën e shkurtër, sakrificën dhe rrugëtimin e karrierës së dëshmorit Toçi, Ministri Imami theksoi: "Për vlerat e tij, Ai do të dekorohet me "Urdhrin e Flamurit të Klasit të I-rë", nga Presidenti i Republikës në vitin 1994. Duke cituar një pjesë nga fjalët e Dëshmorit të Atdheut, Ministri Imami tha: "Këta që flasin me fjalë të bukura dhe që e mbajnë veten të qytetëruar, në fakt justifikojnë robërinë e popujve", -shprehej në ditët e pushtimit fashist të Shqipërisë ai, duke iu drejtuar shokëve me fjalët: "S'ka mbetur rrugë tjetër, veçse të hedhim armët dhe robën fashiste, e të kthehemi në Atdheun tonë.

Transfuzionit të Gjaku për trajnim dhe dhurim gjaku




Prenga shprehet për gazetën "Ushtria" se jam kërenar me efektivat që drejtoj, pasi ata jo vetëm dhurojnë gjak, por dhurojnë dhe paqe në botë. Ata kanë treguar se dinë të vlerësojnë taksapaguesit shqiptarë, popullin që ka nevojë për ndihmën e tyre, ashtu si ka nevojë i sëmuri për shenim". Ai ben apel që në këtë nismë humanitare për të dhuruar sa më shumë gjak të bashkohen sa më shumë ushtarakë e civilë të FA, të cilët ashtu si kanë treguar gatishmëri pranë popullatës në raste të emergjencave civile, po ashtu të gjenden edhe pranë femijëve talasemikë që kanë nevojë për gjakun e tyre të pastër. Përfaqësuesja e Kryqit Kuq Shqiptarë Xhuljeta Muçolani, shprehet se vlerësoj kontributin human të ushtarakëve, pasi ashtu si ata janë bërë tashmë "Ambasadorë të paqes në botë" përkrah ushtrive aleate, po ashtu janë bërë "Ambasadorë të shpëtimit të jetës".

SKËNDERBEU

Një strateg i madh ushtarak

Nga ALBA MUSARAJ

*Një udhëtim drejt
Krujës...Mali, deti
në horizont, ullinjë,
pazari antik, kalaja
madhështore...Sa
emocione dhe his-
tori...! Kthehem në
retrospektivë...*



Gjergj Kastrioti Skënderbeu personifikon një epokë të historisë kombëtare të shqiptarëve, që mori emrin e tij, luftën më se një shekullorë të tyre kundër vërshimit osman për mbrojtjen e tokës, të pasurisë e të lirisë. Nën udhëheqjen e tij lufta e shqiptarëve u ngrit në një shkallë të lartë e të organizuar, shenoi një kthesë vendimtare në zhvillimin politik të vendit dhe në forcimin e vetëdijes kombëtare të tyre. Ai ishte përfaqësuesi më konsekuent dhe më i shquar i elitës drejtuese shqiptare, që udhëhoqi me vendosmëri frontin e luftës së shqiptarëve kundër pushtuesve osmanë.

Skënderbeu jetoi në një periudhë sa të trazuar po dhe aq të rëndësishme në historinë e shekullit të XV. Në Evropën Perëndimore dhe Qendrore po konsolidoheshin principatat dhe monarkitë kombëtare. Ai i dha një ndryshim jetës së tij, duke lënë pas me zgjuarsinë dhe aftësi ushtarë turke dhe fenë islame, duke marrë qytetin e Krujës dhe duke u ribashkuar me fenë e krishterë u bë pikënisje për fillimin e një epoke shpëtimtare të Shqipërisë. Ai ngriti popujt e Shqipërisë dhe Maqedonisë duke formuar Lidhjen e Princiërve kundër pushtuesit turk në vitin 1444. Skënderbeu, si Kapiten i Përgjithshëm i Shqipërisë eksperimentoi aftësitë e tij të shkëlqyera të strategjisë, pavarësisht mungesës së burimeve dhe numrit të kufizuar të ushtarëve, në luftimet e ashpër, të palodhura, të vështira e heroike kundër forcave të Sulltan Muratit II dhe pasardhësit të tij Muhamedit të II, duke penguar përparimin e agjer të turqve në Evropë duke dalë fitimtar në 24 fushata luftar.

Ai e kaptoi më qartë se kushdo tjetër detyrën që shtronte çasti historik: nevojën e bashkimit politik si kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e interesave të të gjitha shtresave shoqërore, të pasura e të varfra, të kercënuara tashmë prej pushtuesve osmanë në çështjet jetike. Njohja e thellë e jetës, e botëkuptimit, e traditës dhe e luftës së shqiptarëve kundër pushtimit të huaj si dhe e organizimit të shtetit e të ushtrisë osmane, i dhanë mundësi Skënderbeut të ndërtonte me efektivitet të lartë gjithë veprimtarinë e tij si burrë shteti dhe

udhëheqës ushtarak i shquar. Skënderbeu arriti në përfundim se, përballë një pushtuesi të fuqishëm siç ishte Perandoria Osmane, shqiptarët nuk mund të arrinin në fitore pa kapërcyer copëtimin politik të vendit, pa një bazë organizative të qëndrueshme, pa bashkërendimin e njetëve dhe të burimeve njerëzore, ekonomike, ushtarake e materiale, pa bashkërendimin e të gjitha vep-

timeve që zhvilloheshin në rrafsh të brendshëm gërshtuar me veprimet e ndërmarrja në rrafsh ndërkombëtar. Kështu ai u bë themeluesi i shtetit të pavarur shqiptar. Gjithashtu ai i kushtoi një kujdes të veçantë ruajtjes së burimeve të brendshme ekonomike, mbi të cilat u mbështet lufta. Në kushtet e epërsisë së theksuar të ushtrive osmane në luftëtarë e

në armatime, Skënderbeu për t'i mposhtur ato i mbante në alarm të përhershëm, i shqetësonte me sulme të vogla e të papritura, u priste rrugët e furnizimit dhe pasi i kishte futur në kurth, i godiste me sulme të fuqishme e të befasishme dhe i shkatërronte përfundimisht. Ai zbatoi një strategji të mbrojtjes aktive sipas parimit "mbrohu duke sulmuar". Në betejat e ndryshme ndërthurur mjeshërisht op-

eracione të mëdha taktike-strategjike me tërheqje e sulme, me pusi e befasi të luftës guerile.

Personaliteti i Skënderbeut si burrë shteti, strateg i mjeshër i art ushtarak dallonte nga mbretërit princërit evropianë të kohës. Ndrysh nga veprimtaria ushtarake e tyre, e bazohesh mbi trupat mercenare të a matosura rëndë, ai u mbështet mbi ushtri të armatosur lehtë, me lëvizshmëri të madhe e aftësi të lartë goditëse të formuar kryesisht nga vullnetarë i kishin gatishmëri luftarake dhe shpirtvetëmohimi. Gjithashtu edhe ai ve luftonte i pangarkuar me armatën të rëndë e me krah të shpërvjelur një ushtar i zakonshëm. Në betejat ishte në të njëjtën kohë komanda i talentuar dhe ushtar i guximshëm i cili me shembullin e tij bëhej burim frymëzimi për luftëtarët shqiptarë. Jetën e përditshme Skënderbeu ishte thjeshtë dhe kohën e kalonte kryesisht me bashkëluftëtarët e tij duke bërë jetë ushtar. Figura e Skënderbeut ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen e ushtarakeve, të burrave të shtet e në përgjithësi të opinionit pub evropian, të cilët kanë kërkuar të rirrin mësim nga përvoja luftarak shqiptarëve, sidomos kur vendet e luftonin kundër pushtuesve të huaj

Shahin Toçi, patrioti që i kushtoi jetën shqiptarizmit

Një vrasje e shëmtuar tronditi në 26 majin e vitit 1939 rrugën Trastevere në Romë. Një i ri shqiptar, me emrin Shahin Toçi, i sapodiplomuar në Akademinë Ushtarake, u gjend i vdekur nga autoritetet italiane. Shumë hipoteza do të hidheshin për shkakun e vdekjes, shumë pikëpyetje qëndronin rreth shkakut të saj, por e vërteta mbeti e pazbuluar. Shteti italian e arshivoi dosjen Toçi, ndoshta për të fshehur atë që kishte ndodhur realisht, e që kishte lidhje me aktin e madh patriotik të këtij shqiptari nga Mati. Dy javë para se të gjendej i vrarë, Shahin Toçi kreu një gjest i cili sot, në distancën e 70 vjetëve, rezaton patriotizëm dhe burrëri të spikatur. Është pikërisht ai qëndrim i fortë prej shqiptari patriot, i cili ndoshta i kushtoi jetën, në mesin e një Italie të pushtuar nga ethet e fashizmit dhe të dominuar nga kërmushat e zeza. Megjithatë, para se të komentojmë vdekjen e tij, le të shohim çili që dhe çfarë përfaqësonte ky djalos i ri 21 vjeçar. I lindur në 30 tetor 1918, Shahin do të shquhej shpejt për cilësitë e tij jeta e Shahin Toçi, peripecitë e studimeve në Itali dhe pengjithësisht egzistenca e tij në pjesën e fundit të jetës, kanë qenë një dramë e vërtetë, e cila zhvillohej larg atdheut dhe që përfshinte dinamiken e ngjarjeve të turbullta për Shqipërinë, në vitin 1939. I mreshtuar, edhe për shkak të prejardhjes, në krah të Mbretit Zog, Shahin Toçi do të provonte një dilemë të fortë të brendshme, në ditët kur Italia do të pushtonte vendin tonë dhe kur i gjithë sistemi shqiptar i vlerave tradicionale do të hynte në krizë. Në debatet mes studentëve shqiptarë, veçanërisht të ndezura në ato momente, ai tregoi gjithnjë i kujdesshëm, për të mos i lënë vend inkonotimeve të lehta



esipërfaqësore. Ishte i bindur se mes propagandës fashiste dhe në një largësi aq të madhe nga vendi, ngjarjet, faktet dhe e vërteta e pushtimit vinin të shtrembëruara, emotive dhe subjektive. Megjithatë Shahin që ndër të parët që hodhën idenë e organizimit të studentëve, për t'u kthyer në Shqipëri dhe për të luftuar për çlirimin e vendit. "Këta që flasin për falë të bukura dhe që e mbajnë veten të qytetëruar, në fakt justifikojnë rolin e popujve", shprehej ato ditë Shahin Toçi. "S'ka mbetur rrugë tjetër, veçse të hedhim armët dhe rroben fashistë, e të kthehemi në atdheun tonë. Atje s'ka humbur besa, as burrëria. Atje mund të organizohemi edhe më mirë, për të hedhur tjetër robëri". Me këto fjalë në gojë, ai debatonte papushim me studentët e tjerë, të cilët i bindeshin pa shumë rezistencë ideve fashiste. Shahin Toçi do të shulte gjithë dëshpërimin momentin kur kurora mbretërore shqiptare do të dorëzohet në Romë nga garda kombëtare, çka do të perjetohet nga ai si një tragjedi e brendshme. Megjithatë, Shahin Toçi diti të qëndrojë si një shqiptar i fortë dhe

në ato ditë të vështira, edhe larg vendit të tij. Me fillim të majit 1939, studentët shqiptarë në Akademinë Ushtarake i mbledhin në një sallë të madhe, për të bërë betimin. Komandanti i Akademisë, si u foli studentëve për lidhjet e reja mes Italisë dhe Shqipërisë, i ftoi ata që të bënin betimin fashist, ku angazhoheshin se do të ishin në shërbim të plotë të Romës. Sipas programit, betimi do të bëhej në një nga sheshet e kryeqytetit italian, në datën 13 maj 1939. Ditën e betimit, në një ceremoni të blinduar nga trupat italiane, ku morri pjesë dhe nensekretari i luftës Pariani, studentët Shahin Toçi u paraqit me një shint kuq e zi, mbi uniformën ushtarake italiane. Ky simbol krijoi peshjellim të dukshëm tek oficerët e lartë që ishin prezent në ceremoni, të cilët i kërkuar të riu nga Shqipëria të hiqte menjëherë shiritin kuq e zi. Ishte gjeneral Pariani, ai që u habit më shumë nga ky gjest. "Ç'vlerë ka kjo uniformë, mbreti juaj ka rënë", iu drejtua ai Toçi. "Edhe mbretërit mund të bien", u përgjigj Shahin Toçi, "edhe uniformat mund të ndërrohen, por ky shirit mbetet". Dësh-

mitarët e atij momenti tensioni dhe se gjenerali italian heshti pas replikës së të riu. Në të kundërt, studentët shqiptarë iu kërkuar që të nesërmer rreshtoheshin sërish, për të rrituar i mulën e betimit fashist. Kur oficerët të lexonte me zë të lartë tekstin, një pasoi ishte një heshtje e thellë. U kuj se studentët nuk kuptonin shqip, në atë çast Shahin Toçi doli nga rre dhe forli me zë të lartë: Zoti gjene jemi shqiptarë dhe betohemi ve para flamurit tonë kuq e zil! Eshhtë tepër të thuhet se ceremonia u p për herë të dytë. Aq sa të nesër studentëve iu kërkuar të paraqites para një komisioni në Ministrin Luftës, për të firmosur (dhe jo thënë zë të lartë), tekstin e betimit usht fashist. Një dorë e kujdesshme e m larg me forcë studentin Shahin Toçi dera e hyrjes: E dimë qëndrimin arrogant, ju nuk pranohet këtu tha atij në portat e ministrisë së Lu. Në këto kushte studentit kurrëzok vetein një ide fikse në kokë: të kti sa më parë në Shqipëri. Por nuk i realizonte dot dëshurën e tij. Një e padukshme i mori jetën në fund-majit 1939, në butjtinë ka nonte në rrugën Trastevere. Është ta quash një vdekje të dyshimtë nga mënyra sesi u konsumua dh nga mesazhi frikësues që mban bn Gjithësesi, humbja e Shahin Toçi t të para pas pushtimit fashist, shkë ngjarje deri dje pak të njohur, e c tregon sesa shumëformëshe dhe plekse ka qenë rezistenca e shqipi ndaj pushtimit të vendit. Shahin është shpallur dëshmor i atdheutn 2004 dhe ka marrë Urdhërin e Fla të klasit të parë në vitin 1994.